

NUMERI I PROTOKOLLIT
Arb. Nr. 209 dt. 01.03.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

851

Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 01.03.2024

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.23

Datë: 28.02.2024

**“NDRYSHIM DESTINACIONI PËRDORIMI TË OBJEKTIT ME NR.PASURIE 323
ZKD. 2178 NGA SHKOLLË 9-VJEÇARE “ZALL LESHE”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE ARRAS, NË QENDËR SHËNDETËSORE”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Kuyzja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 23 Datë 28/02/2024

**“NDRYSHIM DESTINACIONI PËRDORIMI TË OBJEKTIT ME NR.PASURIE 323
ZKD. 2178 NGA SHKOLLË 9-VJECARE “ZALL LESHE”,NJËSIA
ADMINISTRATIVE ARRAS,NË QENDËR SHËNDETËSORE“**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 „Për vetëqeverisjen vendore“, ligji nr. 8744 , datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore“, të ndryshuar,VKM nr.1001 datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare te pronave të paluajtshme publike,shtetërore, që transferohen në pronësi apo ne perdorim të Komunës Arras, të Qarkut Dibrës”ne zbatim të VKM-së nr.28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit te listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve” referuar kërkesës nr.83 prot datë 26.01.2024, protokolluar nga ana jonë me nr.328 prot. date 26.01.2024, ku kërkohet ndryshim destinacioni përdorimi, nga Shkollë në Qendër Shëndetësore me qëllim projekti për rikonstruksionin e kësaj godine. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **28.02.2024** me 21 vota pro,0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Ndryshimin e destinacionit të përdorimit, të objektit me nr. Pasurie 323 zkd. 2178 nga Shkollë 9-vjecare“Zall Leshe”,Njësia Administrative Arras, në Qendër Shëndetësore.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve Pronave dhe Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **28.02.2024**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.209/1 Prot.

Peshkopi, më 04.03.2024

Lënda: Për Vendimin nr. 23, datë 28.02.2024 të Këshillit Bashkiak Dibër.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër

Peshkopi

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 15 "Marrëdhëniet e prefektit të qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore", neni 16 "Verifikim i ligjshmërisë së akteve", verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr. 23, datë 28.02.2024 të Këshillit Bashkiak Dibër, "Ndryshim destinacioni përdorimi të objektit me nr. pasurie 323 ZKD.2178 nga Shkollë 9-vjeçare "Zall- Leshe", Njësia Administrative Arras, në Qendër Shëndetsore", protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 209 prot., date, 01.03.2024. Referuar Ligjit nr 139/2015, " Për vetqeverisjen vendore", nenit 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma 'e', vendosa miratimin në parim të kësaj vendimmarrje për vijimin e mëtejshëm të procedurave në kushtet e respektimit rigoroz të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në këtë fushë, veprim ky që është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturave të posaçme të bashkisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 04, datë, 27/02/2024

PËR

**“NDRYSHIM DESTINACION PËRDORIMI TE OBJEKTIT ME NR. PASURIE 323
ZKD. 2178 NGA SHKOLLË 9-VJEÇARE “ZALL LESHE”, NJËSIA
ADMINISTRATIVE ARRAS, NË QENDËR SHËNDETËSORE”**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM nr. 1001, datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi apo në përdorim të Komunës Arras, të Qarkut Dibër”, në zbatim të VKM-se nr. 28 date 27.01.2023 “ Per percaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve” referuar kërkesës nr. 83 prot., datë 26.01.2024, protokolluar nga ana jonë me nr. 328 prot., datë 26.01.2024, ku kërkohet ndryshim destinacion përdorimi, nga Shkollë në Qendër Shëndetësore me qëllim projekti për rikonstruksionin e kësaj godine. Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e këshillit bashkiak të datës ____/____/2024

PROPOZON :

1. Ndryshimin e destinacionit të përdorimit, të objektit me nr. pasurie 323 zkd. 2178 nga Shkollë 9-vjeçare “Zall Leshe”, Njësia Administrative Arras, në Qendër Shëndetësore.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria Juridike Prokurimeve Pronave dhe Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Drejtori Juridik

Ismet Saraçi

P/ Sektorit të Pronave dhe Strehimit

Gazmend Miftari

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

Ne mungesë dhe me porosi

Zv. KRYETARI


Buzhdi DEDA



Zall-Leshje Arres.

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI BASHKIA DIBER date 21/02/2024 QELIMI Informacion
 VENNDODHJA
 BASHKIA DIBER DVASHK/ZVASHK DIBER Z. KADASTRALE 2178 NP. PAS. 323 INDEX HARTE
 TE DHENAT E PASURISE
 LLOJI PASURISE Fort Nd. SIP. PASURISE M2 4000 m2 SIP. GIURMES NDERTIMIT 90 M2 NUMRI KATEVE NR PEMEVE
 X,Y KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X,Y



X,Y SH.L: 2500 X,Y

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1						
2						
3						

REALIZOI PER SUKJEKTIN SHQIPTAR
 EMRI Ing. Kujtim Hoxha
 LICENCA NR _____ DATE _____
 NTAMPANA _____
 NR. T. _____
 NENSHKRIMI/VULA _____
 REALIZOI PER MSHH _____
 SPECIALISTI _____
 DVASHK _____
 NENSHKRIMI _____
 KONFIRMOI _____
 PFRQJEJGJESI /DREJTORI _____
 NENSHKRIMI/VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE
 Kode per teknologjine e matjeve: T-terren, Z-zyre, D-ortofoto, G-gps,
 S-stacion total, D-matje distancash
 PERCAKTIMI I KUFIRIT
 k. le per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i pronareve, K-kufitare te
 gjithe, KP-kufitare te pjesejshme
 PR-Perfaqesues Bashkie, HK-harta kadastrale
 SHENIME TE VEKANTA
 PRONARI/BASHKEPRONARET: DEKLARIM MBI MAREDMENIET ME KUFITARET
 EMRI: _____
 NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren, Z-Zyre, D-Ortofoto G-GPS, S-Stacion Total, D-Matje Distancash, P-Perfaqesues i
 Pronareve, K-kufitare te Gjithe, KP-Kufitare te Pjesejshme, PR-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta kadastrale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

1031

18.11.15

Nr. 1001 , datë 10.12.2010

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË
TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS ARRAS, TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Arras, të qarkut të Dibrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 33 (tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 204 (dyqind e katër).

Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Arras për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM




LULZIM BASHA

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
19	Prona që përdoren në fushën social - kulturore dhe sportive.	Në pronësi
20-36	Varrezat publike.	Në pronësi
172-197	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike.	Në pronësi
137,138,140,141,143,144, 146,148,149,151,152,154, 155,157,158,160,161.	Prona që përdoren për ushtrimin funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
139,142,145,147,150,153, 156,159,162,163-170 (Vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka inproduktive dhe kanalet e treta)	Në pronësi
198,199	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

MINISTRI

LULZIM BASHA



NR. PROT. 4545/1
DATË 20.12.2010

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË BUIQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJESË SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
KËSHILLIT TË QARKUT TË DIBRËS
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE



INVENTARIZIMI E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
6	1876		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare GRYKE-NOKE	5070	152	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	
7	1876		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare GRYKE-NOKE	4820	162	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	
8	1876		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare GRYKE-NOKE	510	90	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	
9	1876		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare GRYKE-NOKE	1070	108	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	
10	2754		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare Guri 1 zi	884	84	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	
11	2754		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare Mustafe	5244	540	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	
12	2178		Truall Nderfeso	Shkolla 9 vjecare Zall-Leshe	3190	90	Arsim Parauniversitar	MASH	Drejtoria Arsimore	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR DIBËR

Nr. 83 Prot.

Peshkopi, më 26.01.2024

Lenda: Kerkese per miratim.

Drejtuar: Bashkise Diber

Keshillit Bashkiak Diber.

Nisur nga fakti qe Qendra Shendetesore Arras eshte demtuar qe ne vitin 2020 nga rrjedhjet e fuqishme te lumit dhe aktualisht Qendra Shendetesore eshte transferuar ne shkollen 8 vjecare "Zall Leshe" e cila nuk perdoret me si shkolle kerkohet:

Ndryshimi destinacion perdorimi: Nga shkolle ne Qender Shendetesore me qellim projekti per rikonstrukcion te kesaj godine.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!



Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

email: : njvksdiber@shendetesia.gov.al